



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIM

Nr. 26, datë 29.04.2020

MBI

MIRATIMIN PËR PRISHJEN E DETYRUAR TË GODINËS, ME FUNKSION KONVIKT, QË I PËRKET SHKOLLËS SË MESME SPORTIVE “BENARDINA QERAXHI”, QË MBAN NR. 164, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, SI DHE TË GODINËS, QË I PËRKET SHKOLLËS 9-VJEÇARE “HASAN KOÇI”, QË MBAN NR.153, TË LISTËS SË TRANSFERIMIT, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës, PËR SHKAK SE JANË DËMTUAR NGA FATKEQËSIA NATYRORE E DATËS 26 NËNTOR 2019 DHE RIFORCIMI STRUKTUROR I GODINËS NUK ËSHTË E MUNDUR TË BËHET, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT PËR SHKOLLËN E MESME SPORTIVE “BENARDINA QERAXHI”, DHE SE RIPARIMI I NDËRTESËS NUK MUND TË BËHET DHE REKOMANDOHET TË DEMOLOHET, KJO SIPAS AKTEKSPERTIZËS SË THELLUAR, REALIZUAR NGA INSTITUTI I NDËRTIMIT, PËR SHKOLLËN 9-VJEÇARE “HASAN KOÇI”, DHE MIRATIMIN PËR HEQJEN NGA KONTABILITETI DHE LISTA PËRFUNDIMTARE TË DY PRONAVE QË MBAJNË NR. 164 DHE NR.153, QË ME VKM NR. 536, DATË 01.05.2008, KANË KALUAR NË PRONËSI TË BASHKISË Durrës

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, VKM-së nr. 536, datë 01.05.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Durrës”, i ndryshuar, VKM-së nr.796, datë 11.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, VKM-së nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të lejeve të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019

“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, shkresave nr.590 prot., datë 27.02.2020 dhe nr.484 prot., datë 19.02.2020, ardhur nga Instituti i Ndërtimit, me lëndë “Dërgim Akt ekspertizë”, ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore në Bashkinë Durrës, me propozim të Zëvendëskryetares Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Miratimin për prishjen e detyruar të godinës, me funksion konvikt, që i përket shkollës së Mesme Sportive “Bernardina Qeraxhi”, që mban nr.164, të listës së transferimit dhe godinës së shkollës 9-vjeçare “Hasan Koçi”, që mban nr.153, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës, për shkak se janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 Nëntor 2019 dhe rirforcimi strukturor i godinave nuk është e mundur të bëhet, dhe se riparimi i ndërtesës për shkollën 9-vjeçare “Hasan Koçi nuk mund të bëhet dhe rekomandohet të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit Tiranë.
2. Miratimin për heqjen nga lista përfundimtare të pronave, që mbajnë nr. 164 dhe nr. 153, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës.
3. Drejtoria Ekonomike, Sektori i Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve, në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”, të kryejnë veprimet në librat e inventarit ekonomik, përditësimin e listës së pronave të paluajtshme dhe fshirjen në regjistrat e pasurive të paluajtshme Durrës, të pronave me nr.164 dhe nr.153, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Durrës.
4. Toka (trualli) i liruar nga prishja e dy godinave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, nëse i plotëson kushtet për rindërtim (pasi të studiohet për kushtet gjeologjike dhe sizmike), të përdoren për rindërtimin e dy godinave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore.
5. Shpenzimet për shembjen e dy godinave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të mbulohen nga institucionet përkatëse, Inspektoriati Mbrojtjes Territorit Vendor, Durrës.
6. Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Shërbimeve, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të bashkërendojnë punën me Njësinë Zbatuese (Fondin e Zhvillimit), që administron fondet për rindërtim, që transferohen nga Këshilli i Ministrave, prej fondit të rindërtimit, për të realizuar rindërtimin e dy godinave, të përcaktuara në pikën 1 të këtij

vendimi, si dhe përfshirjen në listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të ndërtesave, pas realizimit të rindërtimit.

7. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike dhe Drejtoria e Përgjithshme Ligjore.


Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 30 / 04 / 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 339 / Prot.

Durrës, më 04.05.2020

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 26, datë 29.04.2020 “Mbi miratimin për prishjen e detyruar të godinës, me funksion konvikt, që i përket shkollës së mesme sportive “Benardina Qeraxhi”, që mban nr. 164, të listës së transferimit, si dhe të godinës, që i përket shkollës 9-vjeçare “Hasan Koçi”, që mban nr.153, të listës së transferimit, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, kanë kaluar në pronësi të bashkisë Durrës, për shkak se janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore e datës 26 nëntor 2019 dhe riforcimi strukturor i godinës nuk është e mundur të bëhet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit për shkollën e mesme sportive “Benardina Qeraxhi”, dhe se riparimi i ndërtesës nuk mund të bëhet dhe rekomandohet të demolohet, kjo sipas aktekspertizës së thelluar, realizuar nga Instituti i Ndërtimit, për shkollën 9-vjeçare “Hasan Koçi”, dhe miratimin për heqjen nga kontabiliteti dhe lista përfundimtare të dy pronave që mbajnë nr. 164 dhe nr.153, që me VKM nr. 536, datë 01.05.2008, kanë kaluar në pronësi të bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që më jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

